

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia Ymeri, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimit "S." V. I. G. sh.a me seli në P. Rr.P. V. p.n, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh. G. nga P., kundër të paditurës KRM "H." sh.a. me seli në Gj., të cilën me autorizim e përfaqësoj B. O., lidhur me borxhin në shumë prej 3.422,04€, në seancën e mbajtur më dt. 07.07.2015, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit dhe përfaqësuesit të autorizuar të së paditurës ndërsa me datën 10.08.2015, merrë këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Kompania e Sigurimit "S." V. I. G. me seli në P..

I.DETYROHET e paditura KRM "H." sh.a. me seli në Gj. që në emër të borxhit, t'ia paguaj paditësit shumën e mbetur në lartësi prej 3.422,04 € (tre mijë e katërqind e njëzetë e dy euro e katër cent), së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 3.5%, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë data 27.06.2011 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarrimit me detyrim.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 615.00€, në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania e Sigurimit "S." V. I. G. me seli në P. me datë 27.06.2011, ka ushtruar në Gjykatë padi për pagesën e borxhit të mbetur në vlerë prej 3.422,04euro, kundër të paditurës KRM "H." sh.a. me seli në Gj..

Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin IV.C.nr.210/2011 e datës 01.09.2011 kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Kundër këtij aktgjykimi e paditura kishte ushtruar ankesë në bazë të të cilës Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ae.nr.265/2012 e datës 06.11.2013, ankesën e paditurës e ka aprovuar ndërsa lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore ka mbajtur seancat në të cilën i autorizuari i paditësit, pas marrjes së ekspertizës ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe ka kërkuar në emër të borxhit të mbetur shumën prej 3.422,04 €, me kamatë ligjore prej 3.5% duke filluar nga data paraqitjes së padisë 27.06.2011 e deri në pagesën definitive, duke shtuar se me të paditurën kanë qenë në raport kontraktues lidhur me kontratën për sigurimin e të gjitha automjeteve të KRM "H." sh.a –Gj., ku këtë kontratë janë përfshirë afatet kohore për kryerje e shërbimeve për periudhën 1 vjeçar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Përfaqësuesja e të paditurës në parashtrës dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë duke shtuar se e paditura nuk i ka pranuar faturat ashtu si që është e parapar me neni 11.2 të kontratës ,dhe për këtë fakt paditësja ka ra në kundërshtimin me kontratën .Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore, i ka administruar provat e prezantuara si në vijim: kontrata për shërbime nr.518 e datës 10.07.2009,specifikacioni i çmimeve,fatura e dt.27.04.2010, konfirmimi i dt.10.12.2010, fatura 11.05.2010, konfirmimi i dt.10.12.2010, fatura dt.27.05.2010, konfirmimi i dt.10.12.2010, fatura 29.05.2007, konfirmimi i dt.10.12.2010, fatura 28.05.2010, konfirmimi i dt.10.12.2010, fatura 16.06.2010, konfirmimi i dt.10.12.2010, fatura 33.7.2009, konfirmimi i dt.10.12.2010,fatura 31.07.2009, konfirmimi i dt.10.12.2009.

Duke vlerësuar provat e administruara edhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse gjykata ka ardh në përfundim sikurse vijon:Në mes të palëve ndërgjyqëse ekziston një kontrat e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse e hartuar me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur ,kështu nga kjo kontratë rrjedh se paditesi ka pas detyrim ta paguaj shumën prej 9.201,16 euro për sigurimin e të gjitha automjeteve të KRM”H.”sh.a –Gj. ,dhe se afati për kryerjen e shërbimeve kanë qenë prej dt 13.07.2009 e deri me datë 13.07.2010.Andaj nuk është kontestuse fakti se e paditura KRM “H.”sha me seli në G. nuk e ka përmbush detyrimin e marr sipas kontratës,ndërsa kontestues në këtë çështje juridike-civile ishte sipas pretendimit të të paditurit se nuk i ka pranuar faturat ashtu sipas nenit 11 pika 2 të kontratës .

Për të vërtetuar këtë çështje kontestimore lidhur me lartësin e borxhit Gjykata ka angazhuar ekspertin financiar A. G. nga P. i cili me shkrim ka dorëzuar mendimin dhe konstatimin e saj, dhe ka cek se borxhi i të paditurës arrinë shumën prej 3.422.04euro.

Duke u bazuar në mendimi dhe konstatimin e ekspertit financiar Gjykata ka vërtetuar faktin se policat janë lëshuar dhe shfrytëzuar nga e paditura dhe borxhin e mbetur dhe të pa paguar nga e paditura është në shumë prej 3.422.04 euro, vërtetimin e ekzistimit të këtij detyrimi është mbështet në kontratën me nr.518 te dt.10.07.2009,në libra afariste,nga bisedat në mes palëve në procedurë,si dhe nga shkresat të cilat gjinden në lëndë,dhe mbi bazë të kësaj është paraqitur gjendjen e tërësishme të detyrimit të krijuar në formë tabelare duke paraqitur të gjitha ndryshimet lidhur me të gjitha policat e sigurimit të automjeteve,si dhe pagesat që janë realizuar për borxhin në bazë të policave nga KS S. për KRM H. nga Gj.,mandje policat e sigurimit për të cilat dokumentacioni nuk ka qenë i rregullt dhe në fund borxhi i mbetur pa u paguar nga pala e paditur.Gjykata e ka vlerësuar se mendimin dhe konstatimi i ekspertit financiar është objektiv dhe i panashëm si dhe në përputhje me provat tjera që gjinden në shkresa të lëndës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e palës së paditur lidhur me at se nuk i ka pranuar faturat ashtu si që janë paraparë në kontratë përkatësisht në nenit 11 pika2, e konsideroj sit ë pabazuar për arsye se policat e sigurimit janë shfrytëzuar nga e paditura ashtu sic është vërtetuar edhe me ekspertizën financiare, në këtë menyrë me vet faktin që janë shfrytëzuar policat e sigurimit, ato mundë të cilësohen si instrument financiar në bazë të cilave mund të bëhet pagesa e borxhit.

E paditura ka dhënë vretje në mendimin dhe konstatimin e ekspertit financiar gjykata e vleroj si të pabazuar pasi që e paditura nuk ka gjetë interesim ta ftoj ekspertin në seancë që ti parashtrij pyetje lidhur me kundërshtimet e tij, e aq më tepër e paditura heq dorë edhe nga propozimi për caktimin e ekspertizës së re financiare, kështu e paditura nuk i ofroj prova për të cilën do ta bazonte pretendimet e tij ashtu si që është e paraparë sipas nenit 319 të LPK-se.

Andaj gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata për të vendosur drejt në këtë çështje juridiko kontestimore, duke iu referua dispozitës së nenit 17 paragrafi 1 të LMD-së, i cili parasheh se pjesëmarësit e marrëdhënjes së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij.

Sipas nenit 262 paragrafi 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj borxhin në shumën e gjykuar.

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, gjykata e detyroj të paditurën që t'ia paguaj paditësit, shumën e gjykuar së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 3,5%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Lartësia e kamatës në rastin konkret, i referohet shkallës së kamatës, të cilën e paguajnë bankat afariste në Republikën e Kosovës, për mjetet e deponuara pa destinim dhe për periudhën kohore të deponimit, me shumë se për një vit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi, dhe atë: për taksën në padi shumën prej 25 euro, në emër përfaqësim për 2 seanca (2x270.40 euro) në shumë prej 540.00 euro, dhe për 2 aktgjykime (2x25,00) në shumë prej 45.00 €, gjithësej shumën prej 615.00 euro.

Gjykata duke u bazuar në nenin 262 dhe 277 të KMD-së si dhe në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

–Departamenti Për Çështje Ekonomike–
III.C.nr. 378/2014 me datën 10.08.2015

Gjyqtarja

Franciska Zhitia Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, llogaritur nga dita e pranimit të të njëjtit, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.